

Instituti AL-TAX
Dokumente Fiskale
www.al-tax.org
altax@consultant.com
02/08/2012
Tiranë, Shqipëri

Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave

D I V A

Sqarime për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat individuale, 2012

Dokument për njohjen e zbatimit e tatimit mbi të ardhurat individuale

Komente dhe sqarime mbi Deklarimin Individual Vjetor të të Ardhurave në Shqipëri, SL12-02

Ky informacion mujor është përgatitur nga ekspertët e AL-TAX dhe do të pasohet nga dokumente të tjera, në serinë e përmbledhjeve tematike, me synimin që të kthehet në një burim diskutimi për gjithë ata që interesohen, ose kanë lidhje të pandashme me tatimet në zbatimin e praktikave të tyre. Autorësia është e AL-TAX, dhe nga cdonjëri që do të përdorë këtë material, kërkohet të shënojë autorësinë, si referencë në materialet që do të përdorë.

Dokumenti gjendet te faqja në internet www.al-tax.org

Nëse keni kërkesa dhe pyetje dërgojini te altax@consultant.com

DIVA - Dje, Sot dhe Nesër...

Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave (DIVA) e filloi rrugëtimin e saj në përpjekjen e parë të qeverisë për të filluar deklarimin në vitin 2005. Në po atë vit u vendos nga qeveria si një moment që nuk përkonte me kushtet dhe infrastrukturën e kulturës fiskale të individëve dhe administratës për të mundësuar arritjen e këtij objekti fiskal.

Në vitin 2009 u ridiskutua nga qeveria në konsultim me ekspertët e huaj për të filluar me deklarimin individual të të ardhurave duke plotësuar një boshllëk dhe duke rritur nivelin e barazisë para ligjit.

Në vitin 2010 dialogu i filluar dhe vazhduar në formate dhe panele, me pjesëmarrjen e biznesit dhe organizatave që përfaqësojnë ata dhe qytetarët u finalizua me draftimin dhe dërgimin në Kuvend të ndryshimeve ligjore, që rregullojnë modalitetet për këtë ridimensionim të administrimit tatimor në Shqipëri. Për herë të parë në historinë fiskale të vendit secili qytetar rezident, por edhe secili mysafir në Shqipëri që përfiton të ardhura në vend do të jetë kontribues në buxhetin e shtetit. Ligji Nr.10343, datë 28.12.2010 sanksionoi fillimin e rrugëtimin pa kthim të deklarimit të të ardhurave.

Po çfarë kërkon prej individit dhe si e trajton atë ky ligj?

Detyrimi lind në nivelin individual dhe nuk lidhet me mënyrën e organizimit në shoqëri dhe familje. Prej vitit 2011, secili individ që realizon të ardhura vjetore nga të gjitha burimet në shumën totale më shumë se 2,000,000 leke (përfshirë individët rezidentë me të ardhura brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe jo rezidentë me të ardhura brenda territorit të Republikës së Shqipërisë) duhet të deklarojë ato deri në fund të Shtatorit 2012. Individët brenda familjes që kanë të ardhura nga burime të ndryshme janë të detyruar të deklarojnë individualisht, nëse plotësojnë kriterin e realizimit të të ardhurave. Por, DIVA mund të plotësohet edhe nga persona të tjerë, që vendosin të bëjnë deklaratën, megjithëse nuk kanë detyrimin ligjor për këtë, për arsye se duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme.

Perjashtohen nga detyrimi per plotesimin dhe dorezimin e deklarates individuale çdo individ, që realizon të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën totale më pak se 2,000,000 leke. Ky ligj nuk i përjashton zyrtarët që kanë detyrim ligjor deklarimin e pasurisë. Deklarata që ata bëjnë mund të përdoret si një argument shtesë për burimin e shumave të të ardhurave vjetore të realizuara nga ta.

Te ardhurat qe jane objekt deklarimi dhe tatimi janë:

- a) të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët dhe fitimi nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit të vogël, që rezulton nga Deklarata e të Ardhurave Personale të Biznesit të Vogël për të vetëpunësuarit;
- b) të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit;
- c) të ardhurat bruto nga qiraja dhe fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të deklaruesit;
- d) të ardhurat bruto nga interesa bankarë;
- e) fitimi kapital neto, i krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme;
- f) shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit;
- g) të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuri të tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike;
- h) fitimi kapital nga dhurimi;
- i) të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- j) të ardhura bruto të tjera.

Por, gjithsesi ligji i përjashton gjithë individët që marrin të ardhura nga:

- a) skema e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si përfitim, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulta;
- b) shteti për bursa për edukim (nxënës dhe studentë);
- c) shteti si shpërblim, në raste sëmundjesh, fatkeqesish;
- d) shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publike pronarëve;
- e) aktivitete të grupuara në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi;
- f) kompensime financiare (ish-pronarët dhe ish të dënuar politikë);
- g) kontributet e bëra nga punëdhënësi për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve.

Të ardhurave që janë objekt deklarimi mund t'u zbriten shpenzimet e zbritshme, që janë:

- a) Kontributet vullnetare ne fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare te individit per jeten dhe shendetin, te derdhura nga vetë individi, si dhe pjesa e shpenzimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Kufiri maksimal per lehtësi tatimore per kontributet vjetore eshte vlera me e vogel qe del nga krahasimi i shumes 200 000 leke në vit dhe 15 % te te ardhurave vjetore bruto te anetarit te fondit;
- b) shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari;
- c) shpenzimet për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sipas përcaktimeve të rregulluara me vendim të Këshillit të Ministrave;

Brenda një familje, me të ardhura totale vjetore bruto të secilit prej pjestarëve të saj tyre deri në shumën 1,050,000 lekësh, për përfitimin e shpenzimeve të zbritshme mund të plotësohet një deklaratë vetëm nga kryefamiljari. Në rastin kur pjestarët e familjes kanë të ardhura vjetore bruto vjetore deri në shumën 1,050,000 lekë, ndërsa kryefamiljari e kalon limitin prej 1,050,000 lekë apo edhe 2,000,000 lekë, atëherë deklarata për përfitim nga shpenzimet e zbritshme mund të plotësohet vetëm nga gruaja e tij. Personat jorezidentë nuk përfitojnë nga e drejta e llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme.

Për çdo të ardhur dhe shpenzim, të referuar në deklaratën vjetore të të ardhurave, tatimpaguesi që bën deklaratën mban kopje origjinale të dokumentit që provon të ardhurën apo shpenzimin e zbritshëm ose fotokopje të njësuar nga institucioni lëshues i dokumentit. Në rastin kur deklarata dorëzohet elektronikisht, dorazi apo me postë, skanime/fotokopje e këtyre dokumenteve i bashkëlidhen deklaratës vjetore të të ardhurave. Originali i tyre, në çdo rast, ruhet në përputhje me legjislacionin fiskal dhe vihet në dispozicion të administratës tatimore, kur kërkohet prej saj.

Diferenca midis totalit të të ardhurave bruto dhe shpenzimeve të zbritshme përbën të ardhurën e tatueshme të individit e cila tatohet me shkallën tatimore në fuqi 10 për qind. Nëse diferenca është pozitive, deklaruesi, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave, bën pagesën e tatimit. Nëse diferenca është negative, administrata tatimore ia kthen deklaruesit shumën e



Law. Tax. Accountability

altax@consultant.com

www.al-tax.org

taksave të paguara më tepër ose, me pëlqim të deklaruesit, kjo shumë mund të përlogaritet si pagesë e kryer për vitin tatimor vijues

Shumës së këtij tatimi, i zbriten tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore të dokumentuara nga mbajtësi në burim i këtyre tatimeve.

Për individët rezidentë fiskalë shqiptarë, që kanë realizuar të ardhura dhe janë taksuar për to jashtë Republikës së Shqipërisë në vende me të cilat Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, tatimet e paguara të vërtetura nga autoritetet e këtyre vendeve, janë të zbritëshme. Në rast se të ardhurat i kanë realizuar dhe u janë taksuar jashtë Republikës së Shqipërisë në vende me të cilat Shqipëria nuk ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, tatimet e paguara nuk janë të zbritëshme.

Rasti më i ndeshur do të jetë për të ardhurat e emigrantëve, që janë rezidentë shqiptarë (ose jorezidentë shqiptarë). Edhe pse mund të dërgojnë para pranë familjes së tyre në Shqipëri, nëse ato janë tatuar në vendin ku ata jetojnë ato janë objekt për tu kredituar dhe mos të paguhet dy herë duke përmbushur kriteret në rastet kur përjashtohet tatimi sipas Marrëveshjeve për eliminimin dhe shmangien e taksimit të dyfishtë.